



INSTITUCIONET MUZEALE TË QYTETIT TË PEJËS



INSTITUCIONET MUZEALE TË QYTETIT TË PEJËS

Autore: Flaka Xërxa Beqiri, Arta Januzi Cana, Marigona Rexha

Botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci Nr.67, Prizren, Rr. Xhemajl Mustafa 9/1 LL-4 Nr.7

www.ecmandryshe.org

info@ecmandryshe.org

029 222 771

Shtator, 2026

Hulumtimi “Institucionet Muzeale të Qytetit të Pejës” u realizua në kuadër të projektit “Trashëgimia kulturore për të gjithë: Ruajtja, edukimi, zhvillimi dhe inovacioni” përkrahur nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të donatorëve.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË
DHE SPORTIT

PËRMBAJTJA

HYRJE

1 METODOLOGJIA DHE QËLLIMI I DOKUMENTIT

2 KONTEKSTI: PEJA DHE INSTITUCIONET MUZEALE

3 HISTORIKU I SHKURTËR I MUZEVE NË PEJË

4 GJENDJA AKTUALE E OBJEKTEVE MUZEALE

4.1 OPERIMI, KAPACITETET NJERËZORE DHE SHËRBIMET E OFRUARA

4.2. ANALIZA E HAPËSIRAVE DHE E RRJEDHËS SË LËVIZJES

4.3. QASSHMËRIA PËR VIZITORËT

5 PROBLEMET DHE PROPOZIMET

6 PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME STRATEGJIKE PËR TË ARDHMEN

7 PËR EC

SHTOJCA 1: DOKUMENTIMI DHE ANALIZA E INSTITUCIONEVE MUZEALE TË PEJËS –
PJESA GRAFIKE

HYRJE

Muzetë janë institucione publike me rol të shumëfishtë: mbledhin, dokumentojnë, ruajnë, hulumtojnë, interpretojnë dhe ekspozojnë trashëgiminë e prekshme dhe të paprekshme. Përtej funksionit të ekspozimit, ato krijojnë lidhje ndërmjet kujtesës historike dhe jetës bashkëkohore, mbështesin edukimin joformal dhe ofrojnë hapësirë për reflektim, dialog e përfshirje shoqërore. Në kuptimin bashkëkohor, cilësia e një institucioni muzeal nuk vlerësohet vetëm nga rëndësia e koleksionit, por edhe nga mënyra e administrimit, ruajtjes, interpretimit, qasshmërisë dhe komunikimit me publikun.

Në Pejë, ky rol përfaqësohet në mënyra plotësuese nga Muzeu i Pejës dhe Kompleksi i Mullirit të Haxhi Zekës. Muzeu i Pejës ruan dhe prezanton koleksione etnologjike dhe arkeologjike që dëshmojnë jetën, kulturën materiale dhe zhvillimin historik të Pejës e të Rrafshit të Dukagjinit. Kompleksi i Mullirit të Haxhi Zekës, ndërkaq, është monument i trashëgimisë industriale dhe dëshmi e modernizimit ekonomik e teknologjik të qytetit gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX.

Të dy asetet kanë pozita të rëndësishme në strukturën urbane dhe në identitetin kulturor të Pejës, por funksionojnë në kushte të ndryshme. Muzeu i Pejës është institucion aktiv, me staf, orar, koleksion dhe kalendar aktivitete, ndërsa Kompleksi i Mullirit duhet trajtuar njëkohësisht si monument i mbrojtur, hapësirë interpretuese dhe potencial për programim kulturor. Për këtë arsye, dokumenti nuk i barazon si dy muze me të njëjtin status, por i analizon sipas rolit, funksionit dhe gjendjes së secilit.

Hulumtimi synon të krijojë një pasqyrë të përbashkët mbi vlerat, kapacitetet dhe mangësitë e tyre, duke lidhur të dhënat institucionale me dokumentimin arkitektonik e hapësinor. Gjetjet shërbejnë si bazë për masa të realizueshme në fushën e konservimit, qasshmërisë, menaxhimit të koleksioneve, interpretimit, digjitalizimit dhe zhvillimit të turizmit kulturor.

1. METODOLOGJIA DHE QËLLIMI I DOKUMENTIT

Qëllimi i dokumentit është dokumentimi dhe vlerësimi i Muzeut të Pejës dhe Kompleksit të Mullirit të Haxhi Zekës në aspektin historik, institucional, arkitektonik, funksional dhe të qasshmërisë. Hulumtimi fokusohet në mënyrën se si këto asete ruhen, përdoren dhe komunikohen me publikun, si dhe në identifikimin e ndërhyrjeve që mund ta përmirësojnë funksionimin e tyre pa cenuar vlerat e trashëgimisë.

Ky publikim është pjesë e një cikli hulumtimesh dhe dokumentimesh të nisur nga EC Ma Ndryshe në vitin 2022, me synim krijimin gradual të një pasqyre krahasuese mbi gjendjen, funksionimin dhe qasshmërinë e institucioneve muzeale në qytetet e Kosovës. Seria ka filluar me publikimin “Institucionet Muzeale të Qytetit të Prizrenit”, të realizuar dhe publikuar në janar 2023, dhe është vazhduar me hulumtimet për institucionet muzeale të Mitrovicës dhe Gjakovës gjatë vitit 2024, si dhe për Prishtinën dhe Ferizajin gjatë vitit 2025. Studimi për Pejën, i realizuar gjatë vitit

2026 paralel me studimin e muzeve të qytetit të Gjilanit, e vazhdon këtë proces, duke përdorur një kornizë të ngjashme analitike, por duke e përshtatur atë me numrin, tipologjinë, statusin institucional dhe karakteristikat specifike të aseteve të trajtuara në secilin qytet.

Qasja metodologjike e këtij hulumtimi mbështetet në modelin e zhvilluar në publikimet paraprake të serisë. Publikimet e kanë ruajtur fokusin e përbashkët në gjendjen fizike dhe funksionale, kapacitetet njerëzore, shërbimet, organizimin e hapësirave, lëvizjen e vizitorëve, qasshmërinë dhe identifikimin e problemeve e propozimeve.

Puna për Pejën është bazuar në katër grupe burimesh: (1) literatura dhe burimet publike mbi historinë e objekteve dhe zhvillimin e institucioneve muzeale; (2) dokumentimi në terren përmes fotografive, matjeve, situacioneve, planimetrive, prerjeve dhe fasadave; (3) analizat grafike të

organizimit hapësinor, lëvizjes së vizitorëve dhe pengesave në qasshmëri; dhe (4) të dhënat e drejtpërdrejta institucionale të ofruara nga Muzeu i Pejës për operimin, personelin, koleksionet, vizitorët dhe shërbimet e këtij muzeu.

Pjesa grafike, e bashkangjitur si shtojcë, është përdorur si mjet analitik. Planimetritë dhe prerjet evidentojnë organizimin e brendshëm dhe lidhjen ndërmjet niveleve; fotografitë dokumentojnë materialet, ekspozimin dhe gjendjen ekzistuese; ndërsa skemat e lëvizjes dhe qasshmërisë identifikojnë pragjet dhe pengesat vertikale.

Hulumtimi është zhvilluar në dy nivele plotësuese. Në nivelin institucional janë shqyrtuar administrimi, personeli, orari, koleksionet, vizitorët, aktivitetet dhe shërbimet e ofruara. Në nivelin arkitektonik dhe hapësinor janë analizuar vendosja në kontekst urban, organizimi funksional, sekuencat e lëvizjes, kushtet e ekspozimit dhe qasshmëria fizike e informative. Ndërthurja e këtyre dy niveleve synon të shmangë trajtimin e muzeut vetëm si ndërtesë ose vetëm si institucion, duke e vlerësuar si sistem ku objekti, koleksioni, stafi dhe publiku varen nga njëri-tjetri.

Dokumenti ka karakter vlerësues dhe strategjik. Ai nuk zëvendëson projektet profesionale të konservimit, auditimet konstruktive, planet e menaxhimit të koleksioneve ose projektet ekzekutive të qasshmërisë. Çdo ndërhyrje fizike në objektet e mbrojtura duhet të zhvillohet në bashkëpunim me institucionet kompetente të trashëgimisë dhe mbi bazën e dokumentimit teknik të detajuar.

2. KONTEKSTI: PEJA DHE INSTITUCIONET MUZEALE

Peja është një nga qendrat historike dhe ekonomike më të rëndësishme të Kosovës perëndimore. Pozita në hyrje të Grykës së Rugovës, lidhja me Bjeshkët e Nemuna dhe zhvillimi përgjatë Lumëbardhit kanë ndikuar në formimin e qytetit si qendër tregtare, zejtare dhe kulturore. Struktura urbane e qytetit bashkon bërthamën tradicionale, hapësirat publike qendrore, rrjetin e çarshisë dhe shtresat e zhvillimit modern.

Muzeu i Pejës ndodhet afër Sheshit Haxhi Zeka, Lumëbardhit, Urës së Gurit dhe Çarshisë së Gjatë. Kjo pozitë e vendos muzeun brenda një sistemi të përqendruar të trashëgimisë dhe hapësirave publike, me potencial për vizita të kombinuara në këmbë. Objekti ka oborr të rrethuar me dalje në 2 anë.

Kompleksi i Mullirit të Haxhi Zekës gjendet në pjesën veriore të qytetit, pranë ish-zonës së tregut dhe akseve kryesore rrugore. Figura 1 evidenton distanca këmbësore rreth 1.1–1.2 km ndërmjet dy aseteve, përkatësisht afërsisht 16–17 minuta ecje, varësisht nga itinerari. Kjo afërsi krijon mundësi reale për zhvillimin e një itinerari kulturor që lidh muzeun, sheshin, çarshinë dhe trashëgiminë industriale.

Në nivel institucional, Peja ka potencial që këto dy asete t'i trajtojë si pjesë të një rrjeti të përbashkët kulturor, pa humbur specifikat e tyre. Muzeu mund të jetë qendra e koleksioneve dhe interpretimit etnologjik e arkeologjik, ndërsa Mulliri mund të zhvillohet si pikë e interpretimit të historisë industriale, tregtisë dhe modernizimit të qytetit.




Fig. 1 Muzetë e Pejës
(Burimi: Autoret)

3. HISTORIKU I SHKURTËR I MUZEVE NË PEJË

3.1. Muzeu i Pejës



Fig. 2 Muzeu i Pejës
(Burimi: Autoret)

Muzeu i Pejës është i vendosur në Konakun e Tahir Beut, një shtëpi qytetare e shekullit XIX, e ndërtuar fillimisht për banim dhe pritje të tregtarëve e udhëtarëve. Ndërtesa përfaqëson arkitekturën tradicionale qytetare përmes kombinimit të gurit, drurit, strehëve të gjera, dritareve ritmike dhe organizimit të kthinave rreth hapësirave të komunikimit. Konaku është zhvendosur dhe rindërtuar në lokacionin e sotëm pranë Sheshit Haxhi Zeka.

Institucioni u themelua në vitin 1977 si Muze Etnologjik. Ky emërtim lidhej me përmbajtjen fillestare të koleksionit, të

përqendruar te kultura materiale, mënyra e jetesës dhe traditat e Rrafshit të Dukagjinit. Me zgjerimin e veprimtarisë dhe përfshirjen e sektorit të arkeologjisë, institucioni nuk mbeti më vetëm muze etnologjik. Pas bashkimeve dhe riorganizimeve institucionale, në vitin 2015 mori emrin Muzeu i Pejës, duke përfshirë sot sektorët e etnologjisë, arkeologjisë dhe historisë.

Në përdhese gjendet sektori i arkeologjisë, i vendosur në të vetmen kthinë ekspozuese të këtij niveli aktualisht. Kthinat e tjera të përdhësës përdoren kryesisht si zyra dhe depo, si dhe tualeti i stafit nën shkallë. Kjo ndarje shpjegon pse përdhesa nuk funksionon si fillimi i plotë i ekspozitës: vizitorët këtu priten dhe pajisen me bileta mirëpo vizita e ekspozitës etnologjike fillon në katin e parë, pastaj përfundon tek arkeologjia.

Kati i parë ruan karakterin e banesës tradicionale dhe përmban pjesën kryesore të ekspozitës. Dhoma e mysafirëve organizohet në nivele të ndryshme të dyshemesë, të cilat interpretojnë hierarkinë e familjarëve dhe të mysafirëve në përdorimin e hapësirës. Tavani përmban detaje florale të punuara me dorë, ndërsa kthinat janë

të pajisura me një numër të madh mobiliesh, tekstilësh, enësh, veglash dhe objektësh të mbledhura nga familjet e rajonit.

Dhoma e vatrës është paraqitur në kat, ndonëse në tipologjinë tradicionale të banimit një funksion i tillë zakonisht lidhej me përdhesën. Kjo tregon se organizimi aktual duhet lexuar si interpretim muzeal i mënyrës së jetesës dhe jo domosdoshmërisht si rindërtim plotësisht identik i përdorimit historik të çdo kthine.




Fig. 3 Foto nga Muzeu i Pejës (lart) dhe Kompleksi i Mullirit Haxhi Zeka (poshtë)
(Burimi: Autoret)

3.2. Kompleksi i Mullirit të Haxhi Zekës



Fig. 4 Kompleksi i Mullirit të Haxhi Zekës
(Burimi: Autoret)

Kompleksi i Mullirit të Haxhi Zekës u ndërtua në vitin 1890. Punimet u nisën nga Haxhi Zeka, veprimtar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe themelues i Lidhjes së Pejës, ndërsa u përfunduan nga nipi i tij, Jashar Pasha.

Kompleksi ndërthurte ndikime të arkitekturës perëndimore me elemente të arkitekturës vendore dhe fillimisht përbëhej nga gjashtë objekte: mulliri, një kullë trekatëshe, konaku për pritjen e udhëtarëve që vinin nga larg, depoja e miellit, hambari dhe ahuri i kuajve. Mekanizmi i mullirit ishte sjellë nga Austro-Hungaria dhe fillimisht funksiononte me energji ujore, ndërsa më vonë u përshtat për të punuar me

energji elektrike. Sot kanë mbijetuar vetëm disa pjesë të mekanizmit, përfshirë rrotën e mullirit, e cila është e ekspozuar përpara objektit.

Mulliri përdorej për bluarjen e drithërave dhe u shërbente jo vetëm banorëve të Pejës dhe rrethinës, por edhe atyre të Plavës dhe Gucisë. Me kalimin e kohës, kompleksi, i cili fillimisht ishte pronë e Haxhi Zekës, kaloi në pronësi të Komunës së Pejës dhe u përdor për funksione të ndryshme. Për një periudhë ishte në shfrytëzim të Lidhjes Socialiste të Popullit Punues, më pas si kuzhinë popullore e shkollës “Ramiz Sadiku”, ndërsa nga viti 1947 deri më 1974 u përdor nga ndërmarrja “Zhitopromet”.

Përveç rëndësisë ekonomike dhe teknologjike, kompleksi lidhet ngushtë me figurën e Haxhi Zekës dhe me historinë e lëvizjes kombëtare shqiptare. Për këtë arsye, ai bart vlera të rëndësishme industriale, arkitekturore, historike dhe kombëtare. Gjatë viteve, kompleksi pësoi dëmtime të shumta, ndërsa gjatë luftës së viteve 1998–1999 u dogj nga forcat serbe. Nga tërësia e dikurshme sot ruhen vetëm mulliri dhe hambari, të cilët janë restauruar dhe rivitalizuar.

Kompleksi kishte më parë rreth 47 ari pronë, ndërsa pas luftës i kanë mbetur rreth 10 ari në përdorim. Pjesë të tjera të pronës janë zënë ose uzurpuar.

Sot kompleksi vizitohet edhe nga grupe të organizuara. Janë evidentuar vizita të grupeve që vijnë nga Prishtina, përfshirë organizime turistike me tren. Ky interes tregon potencialin e Mullirit si destinacion i trashëgimisë industriale.

4. GJENDJA AKTUALE E OBJEKTEVE MUZEALE

Gjendja aktuale është vlerësuar duke bashkuar të dhënat institucionale, dokumentimin fizik, planimetritë, prerjet, fotografitë dhe vrojtimin e sjelljes së vizitorëve. Hulumtimi tregon se të dy asetet kanë vlera të larta historike, por funksionojnë brenda ndërtesave të adaptuara, me kufizime në shërbime, qasshmëri, siguri dhe interpretim.

4.1. Operimi, kapacitetet njerëzore dhe shërbimet e ofruara

Muzeu i Pejës, ashtu si edhe Kompleksi i Haxhi Zekës administrohet nga Komuna e Pejës, përkatësisht Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Është i hapur nga e hëna deri të premten, nga ora 08:00 deri në 16:00, me pauzë 12:00–13:00.

Në Muzeun e Pejës hyrja është me pagesë, ndërsa kategori të caktuara të vizitorëve përjashtohen nga pagesa sipas praktikës së institucionit.

Treguesi	Gjendja e evidentuar – Muzeu i Pejës
Administrimi	Komuna e Pejës – DKRS
Stafi	5 të punësuar: drejtor, etnolog, historian/arkeolog, dokumentarist dhe punëtor teknik
Orari	E hënë–e premte, 08:00–16:00; pauza 12:00–13:00
Koleksioni	Rreth 800 eksponate të ekspozuara dhe mbi 1,500 të paekspozuara
Vizitorët 2025	3,640 gjithsej: 2,152 vendorë dhe 1,488 të huaj
Vizitorët janar-maj 2026	970 gjithsej: 739 vendorë dhe 231 të huaj
Udhërrëfimi	Shqip, anglisht, turqisht, boshnjakisht dhe pjesërisht gjermanisht
Materialet informuese	Katalogë, broshura, fletëpalosje dhe rrjete sociale
Qasshmëria alternative	Nuk ofrohen Braille, gjuhë e shenjave ose audio-përshkrim

Tab. 1 Kartela e Muzeut të Pejës
(Burimi: Muzeu i Pejës)

Stafi bashkëpunon me institucione të tjera muzeale, kulturore dhe arsimore në

Pejë dhe zhvillon shpesh aktivitete me fëmijë. Këto aktivitete e forcojnë funksionin edukativ të muzeut dhe krijojnë lidhje të drejtpërdrejtë me shkollat dhe komunitetin. Megjithatë, aktivitetet duhet të dokumentohen me numrin e pjesëmarrësve, grupmoshat, temat dhe rezultatet, në mënyrë që ndikimi i programit të mund të vlerësohet ndër vite.

Muzeu nuk ka restaurues ose konservator të dedikuar për eksponatet. Mirëmbajtja e përditshme kryhet nga stafi ekzistues, krahas detyrave të tjera. Kjo është e pamjaftueshme për një koleksion me mbi 2,300 objekte të ekspozuara dhe të paekspozuara, sidomos kur ka shenja lagështie, probleme me kulmin dhe dëmtime në hapësirat ekspozuese. Nevojitet bashkëpunim i rregullt me restaurues të licencuar dhe plan i dokumentuar për konservimin parandalues.

Për Kompleksin e Mullirit të Haxhi Zekës nuk është siguruar kartelë e plotë operative për stafin, orarin, vizitorët dhe shërbimet. Vizitat e organizuara dëshmojnë se objekti përdoret si destinacion kulturor, muzeu është i hapur gjatë ditës 08:00-16:00. Ka një përgjegjëse të Kompleksit për orientim të vizitorëve, si dhe janë prezent

shfrytëzuesit (OJQ-të) e hapësirave të Kompleksit. Kompleksi ka edhe sistem sigurie (me kamera).

Nuk është evidentuar një sistem i katalogimit digjital të koleksioneve

4.2. Analiza e hapësirave dhe e rrjedhës së lëvizjes

Muzeu i Pejës

Në përdhese realizohet pritja dhe marrja e biletave. Vetëm një kthinë, ajo e sektorit të arkeologjisë, është e hapur për vizitorë; kthinat e tjera shërbejnë si zyra dhe depo. Pas blerjes së biletës, vizitori ngjitet në katin e parë, ku fillon rrjedha kryesore e ekspozitës etnologjike, pastaj në fund vizitohet kthina e arkeologjisë. Stafi i Muzeut orienton vizitorët në hapësirë, duke i informuar mbi të gjitha.

Në kuadër të hulumtimit është observuar lëvizja brenda muzeut në tri periudha të ndryshme të ditës, nga një orë për secilën periudhë (fig. 5). Janë ndjekur tri grupe të ndryshme vizitorësh, secili me nga tre persona. Vrojtimi ka shërbyer për të identifikuar sekuencën reale të vizitës (rreth 30min), kohën e ndalimit, kthimet, mbivendosjet, etj.

Të tri grupet kanë ndjekur një model të ngjashëm: hyrja dhe biletat në përdhese, ngjitja në kat dhe lëvizja nga një kthinë në tjetrën. Për shkak të organizimit të konakut, rrjedha nuk është plotësisht lineare; disa dhoma kërkojnë kthim në hapësirën qendrore dhe kalim të përsëritur në pika të njëjta. Kjo funksionon për grupe të vogla, por mund të shkaktojë ngarkesë kur grupet janë më të mëdha ose hyjnë njëkohësisht.

Kati i parë ofron përvojën kryesore muzeale. Dhoma e mysafirëve, tavani me motive florale të punuara me dorë, dhoma e vatrës dhe koleksioni i gjerë i mobilieve krijojnë një ambient të pasur interpretues. Megjithatë, numri i madh i

objekteve dhe mungesa e etiketimit për të gjitha eksponatet e vështirësojnë leximin individual.

Vendosja e muzeut në raport me qytetin është tejet e favorshme. Oborri ka hapje në dy anë dhe lidhet me lëvizjet këmbësore të zonës. Në raste të caktuara, kalimtarët e përdorin oborrin vetëm si kalim, pa hyrë në muze. Kjo sjell jetë dhe dukshmëri, por kërkon ndarje të qartë ndërmjet itinerarit publik të kalimit dhe zonës së kontrolluar muzeale, sidomos jashtë orarit, sidomos pasi që Muzeu nuk ka roje.




Fig. 5. Analiza e lëvizjes në Muzeun e Pejës (Burimi: Autorët)




Fig. 6. Analiza e hapësirave të muzeve të Pejës (Burimi: Autoaret)

Kompleksi i Mullirit të Haxhi Zekës

Mulliri ka organizim industrial me hapësira të mëdha dhe lëvizje vertikale. Pjesa më e madhe e elementeve të brendshme është rindërtuar. Kjo e bën të domosdoshëm interpretimin e ndërhyrjeve: vizitori duhet të kuptojë çfarë është mur autentik, çfarë është rindërtim pas luftës dhe si ka funksionuar aparatura e mullirit.

Lëvizja në këtë kompleks është lineare, nga oborri ku shihen pjesë të mullirit, rrjedhimisht tek pjesa e objektit të mullirit dhe hambarit. Hambari është 3 katësh, ndërsa Mulliri 2 (me nga një hapësirë të lirë në secilin etazh). Të dy objektet shfrytëzohen kryesisht nga OJQ-të dhe 1 person (staf) mbikqyrës i Kompleksit.

4.3. Qasshmëria për vizitorët

Muzeu i Pejës

Muzeu është i arritshëm në nivel qyteti, por jo plotësisht i qasshëm brenda parcelës dhe objektit. Kalldrëmi në oborr vështirëson lëvizjen me karrocë. Ka ngritje në hyrjet e kthinave, ndërsa kati i parë, ku zhvillohet pjesa kryesore e vizitës, arrihet vetëm përmes shkallëve. Kjo do të thotë se vizitori me vështirësi në lëvizje mund të arrijë vetëm një pjesë shumë të kufizuar të përmbajtjes.

Mungojnë tualetet për vizitorë, Braille, audio-përshkrimi, interpretimi në gjuhën e shenjave dhe informacioni paraprak për kufizimet e objektit. Qasshmëria duhet përmirësuar përmes një brezi të rrafshët në oborr, rampave ose trajtimit të pragjeve ku lejohet,

parmakëve, kontrastit vizual dhe interpretimit digjital të katit për personat që nuk mund të ngjiten.

Kompleksi i Mullirit të Haxhi Zekës

Në Mullirin e Haxhi Zekës, shkallët dhe organizimi në disa nivele janë pengesat kryesore. Duhet vlerësuar një itinerar i qasshëm në përdhesë, platformë ngritëse në një zonë me ndikim minimal dhe interpretim virtual për nivelet që nuk mund të arrihen. Sinjalistika e sigurisë, Braille, audio-përshkrimi, interpretimi në gjuhën e shenjave, tualetet për PAK, mungojnë edhe në këtë Kompleks.




Fig. 7. Pengesa fizike në Muzetë e qytetit të Pejës (Burimi: (Burimi: Autoreti))

5. PROBLEMET DHE PROPOZIMET

Vlerësimi ka evidentuar probleme të ndryshme në Muzeun e Pejës dhe në Kompleksin e Mullirit të Haxhi Zekës. Disa prej tyre lidhen me karakteristikat dhe gjendjen specifike të secilit objekt, ndërsa çështje si mirëmbajtja, siguria, qasshmëria, interpretimi dhe menaxhimi kërkojnë përmirësim në të dy institucionet.

Muzeu i Pejës

Edhe pse në vlerësim të parë objekti duket relativisht në gjendje të mirë, analiza më e detajuar ka evidentuar probleme fizike, funksionale dhe të sigurisë, të cilat kërkojnë ndërhyrje të koordinuara.

Gjendja fizike dhe kushtet e punës

- Të trajtohen urgjentisht pikosja e kulmit, lagështia dhe dëmtimet e evidentuara në mure dhe dysHEME, veçanërisht në kthinat ekspozuese. Përpara ndërhyrjeve duhet të realizohet një diagnozë profesionale për identifikimin e burimeve të dëmtimit.
- Riparimi i dritareve, lysterja dhe gëlqerosja duhet të realizohen me materiale dhe teknika të përshtatshme për një objekt të

mbrojtur, vetëm pas eliminimit të burimit të lagështisë.

- Të përmirësohet sistemi i ngrohjes gjatë dimrit, në mënyrë që të krijohen kushte të përshtatshme për stafin, vizitorët dhe koleksionin, pa shkaktuar ndryshime të menjëhershme të temperaturës dhe lagështisë.
- Të sigurohet furnizimi me ujë brenda objektit, tualetet për vizitorët, si dhe një hapësirë minimale për pushim dhe nevojat ditore të personelit.

Siguria dhe menaxhimi i rrezikut

- Të instalohet një sistem i integruar sigurie, që përfshin alarm, kamera, kontroll të hyrjeve dhe monitorim jashtë orarit, pasi muzeu nuk ka roje gjatë natës.
- Të përmirësohet kontrolli i vegjetacionit në oborr, pasi është raportuar rrezik nga paraqitja e gjarpërinjve.
- Duke qenë se oborri ka hyrje nga dy anë dhe përdoret herë pas here si kalim nga qytetarët, duhet të përcaktohet qartë itinerari publik dhe zona e kontrolluar muzeale, sidomos jashtë orarit të punës.

Koleksionet, konservimi dhe interpretimi

- Të angazhohet periodikisht një restaurues ose konservator i licencuar dhe të hartohet plan i konservimit parandalues. Kujdesi për ekspонатet nuk duhet të mbetet vetëm përgjegjësi shtesë e stafit ekzistues.
- Të plotësohet informacioni për të gjitha ekspонатet përmes një sistemi të unifikuar etiketimi, që përfshin titullin, datimin, prejardhjen, materialin, funksionin dhe kodin e inventarit.
- Të digjitalizohet fondi muzeal dhe të zhvillohen ekspozita të përkohshme me rotacion, në mënyrë që mbi 1,500 ekspонатet e paekspozuara të bëhen gradualisht të qasshme për publikun.

Riorganizimi i hapësirave

- Të shqyrtohet mundësia e ndërtimit në oborr të një strukture ndihmëse të lehtë, të kthyeshme dhe të përshtatur me karakterin e monumentit, ku mund të vendosen zyrat, depot, tualetet dhe hapësirat e stafit.
- Zhvendosja e zyrave dhe depove nga kthinat e përdhësës do të

mundësonte zgjerimin e sektorit të arkeologjisë dhe ekspozimin e një pjese më të madhe të fondit muzeal.

- Çdo strukturë e re duhet të paraprihet nga analiza e trashëgimisë, arkeologjisë dhe peizazhit dhe të miratohet nga institucionet përgjegjëse për mbrojtjen e monumenteve.

Qasshmëria dhe përvoja e vizitorëve

- Të krijohet një itinerar i qasshëm nga hapësira publike deri te oborri, hyrja dhe kthina e arkeologjisë në përdhësë.
- Për vizitorët që nuk mund të përdorin shkallët, të ofrohet interpretim alternativ i ekspozitës së katit përmes materialeve digjitale, videove, fotografive, modeleve ose vizitës virtuale.
- Të hartohet një skemë e qartë e vizitës, ku sqarohet se biletat dhe sektori i arkeologjisë ndodhen në përdhësë, ndërsa ekspozita kryesore etnologjike fillon në katin e parë.
- Vizitat në grup duhet të organizohen sipas orareve dhe kapaciteteve të përshtatshme,

pasi vrojtimi ka treguar se lëvizja funksionon më mirë me grupe të vogla.

- Të përgatiten materiale të përshtatura për fëmijë, tekste me lexim të lehtë, audio-përshkrime, titra, video në gjuhën e shenjave dhe informata me kontrast të lartë.

Kompleksi i Mullirit të Haxhi Zekës

Problemet kryesore të kompleksit lidhen me humbjen e një pjese të tërësisë historike, rindërtimin pas luftës, zvogëlimin e pronës, mungesën e interpretimit të qartë të trashëgimisë industriale dhe nevojën për një model më të strukturuar operimi.

Prona dhe integriteti i kompleksit

- Të dokumentohet gjendja juridike e pronës, duke sqaruar raportin ndërmjet rreth 47 arëve që kishte kompleksi më parë dhe rreth 10 arëve që i kanë mbetur sot.
- Të evidentohen parcelat e zëna ose të uzurpuara dhe të shqyrtohen mundësitë ligjore për rikthimin, mbrojtjen ose sigurimin e tyre për nevojat e funksionimit të kompleksit.

- Të dokumentohet shtrirja historike e kompleksit me gjashtë ndërtesa, edhe në rastet kur objektet e humbura nuk mund të rindërtohen, përmes hartave, shenjzimit në terren ose interpretimit digjital.

Autenticiteti dhe rindërtimi

- Në ekspozitë duhet të shpjegohet qartë se kompleksi është djegur gjatë luftës, se janë rindërtuar vetëm mulliri dhe hambari dhe se, përveç pjesëve të ruajtura të mureve, shumica e elementeve të sotme është e rindërtuar.
- Të dallohen qartë pjesët autentike nga ato të rikonstruara përmes materialeve interpretuese, skemave ose shenjzimit diskret.
- Të dokumentohen fazat e restaurimit dhe institucionet që kanë financuar ndërhyrjet, përfshirë fondet e nivelit qendror dhe komunal.

Interpretimi i trashëgimisë industriale

- Të shpjegohet aparatura austro-hungareze dhe mënyra e funksionimit të procesit të bluarjes.

- Të përdoren skema, modele, fotografi historike, video, animacione dhe demonstrime të kontrolluara për ta bërë procesin më të kuptueshëm.
- Të paraqitet roli i kompleksit në zhvillimin ekonomik, tregtar dhe teknologjik të Pejës.

Operimi dhe menaxhimi

- Të hartohet një plan i qartë menaxhimi, ku përcaktohen institucioni përgjegjës, stafi, orari, mirëmbajtja, tarifat, kapaciteti i grupeve dhe mënyra e rezervimit të vizitave.
- Të krijohet një sistem i rregullt për evidentimin e vizitorëve, grupeve të organizuara dhe aktiviteteve.
- Vizitat me grupe të mëdha duhet të planifikohen paraprakisht, për shkak të lëvizjes vertikale dhe kapacitetit të kufizuar të shkallëve dhe kateve, sidomos për personat me vështirësi në lëvizje.
- Të koordinohen vizitat me operatorët turistikë dhe hekurudhorë, përfshirë grupet që vijnë me tren nga Prishtina.

Qasshmëria dhe siguria

- Të krijohet së paku një itinerar i qasshëm në përdhese dhe të shqyrtohet vendosja e një platforme ngritëse në një zonë që nuk cenon vlerat arkitektonike.

Rekomandime të përbashkëta për të dy institucionet

Përtej çështjeve specifike, të dy institucionet kanë nevojë për masa të përbashkëta që përmirësojnë funksionimin dhe lidhjen e tyre me publikun:

- Të realizohet mirëmbajtje e rregullt dhe monitorim periodik i gjendjes fizike të objekteve.
- Të hartohen plane të menaxhimit të rrezikut, sigurisë nga zjarri dhe evakuimit.
- Të përmirësohet qasshmëria fizike, shqisore dhe informative për kategori të ndryshme të vizitorëve.
- Të sigurohet sinjalistikë e unifikuar në shqip dhe anglisht, me mundësi të gjuhëve të tjera përmes mjeteve digjitale.
- Të krijohen materiale të përshtatura për fëmijë, persona me aftësi të kufizuara dhe vizitorë të huaj.

- Të dokumentohen sistematikisht vizitorët, aktivitetet, nevojat e mirëmbajtjes dhe gjendja e koleksioneve ose pajisjeve.
- Të zhvillohet ende bashkëpunimi me institucionet arsimore, kulturore, muzeale dhe turistike.
- Të krijohet një itinerar kulturor që lidh Muzeun e Pejës, bashkë me p.sh Sheshin Haxhi Zeka, Çarshinë, Lumëbardhin dhe Kompleksin e Mullirit të Haxhi Zekës.

6. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME STRATEGJIKE PËR TË ARDHMEN

Muzeu i Pejës dhe Kompleksi i Mullirit të Haxhi Zekës përfaqësojnë dy shtresa plotësuese të trashëgimisë së qytetit. Muzeu i Pejës ruan dhe interpreton kulturën materiale, jetën qytetare, traditat dhe historinë e rajonit, ndërsa Mulliri dokumenton zhvillimin industrial, ekonomik dhe teknologjik të Pejës.

Muzeu i Pejës është institucion aktiv, me staf, koleksion, program aktiviteteve dhe shërbime për vizitorë. Organizimi i tij kushtëzohet nga karakteri i Konakut të Tahir Beut: pritja, marrja e biletave dhe sektori i arkeologjisë ndodhen në përdhesë, ndërsa ekspozita kryesore

etnologjike fillon në kat. Vrojtimi i realizuar në tri periudha njëorëshe, me tri grupe nga tre persona, ka treguar se kjo sekuencë funksionon për grupe të vogla dhe me praninë e ciceronit, por bëhet më e vështirë për grupe më të mëdha dhe për persona që nuk mund të përdorin shkallët.

Përmirësimi i gjendjes fizike, sigurisë, kushteve të stafit, konservimit profesional dhe qasshmërisë duhet të paraprijë zgjerimin e ekspozitave dhe rritjen e numrit të vizitorëve.

Kompleksi i Mullirit të Haxhi Zekës ka potencial të madh për t'u zhvilluar si qendër e interpretimit të trashëgimisë industriale. Megjithatë, ky potencial kufizohet nga humbja e një pjese të kompleksit historik, zvogëlimi i pronës, rindërtimi i gjerë pas luftës dhe mungesa e një modeli të plotë operimi. Interpretimi i ardhshëm duhet të paraqesë në mënyrë transparente dallimin ndërmjet pjesëve autentike dhe atyre të rindërtuara, aparaturën austro-hungareze, procesin e prodhimit, shtrirjen e mëparshme me gjashtë ndërtesa dhe rolin e mullirit në zhvillimin ekonomik të qytetit.

Zhvillimi i ardhshëm i të dy institucioneve duhet të mbështetet në

një qasje të koordinuar, ku ruajtja fizike, menaxhimi institucional, qasshmëria dhe programimi kulturor trajtohen si pjesë të të njëjtit proces. Prioritetet strategjike janë:

- ndërhyrja urgjente në problemet fizike dhe funksionale të Muzeut të Pejës;
- përmirësimi i sigurisë dhe menaxhimit të rrezikut në të dy objektet;
- angazhimi i profesionistëve të konservimit dhe digjitalizimi i koleksioneve;
- lirimi gradual i kthinave të muzeut nga funksionet administrative dhe zgjerimi i hapësirave ekspozuese;
- përmirësimi i qasshmërisë fizike, shqisore dhe informative;
- formalizimi i modelit të operimit dhe dokumentimi i autenticitetit, pronësisë dhe historisë së rindërtimit të Mullirit;
- zhvillimi i interpretimit të trashëgimisë industriale;
- krijimi i itinerarit të përbashkët kulturor ndërmjet muzeut, qendrës historike, Lumëbardhit dhe Mullirit;
- monitorimi vjetor i vizitorëve, aktiviteteve, gjendjes fizike,

konservimit, qasshmërisë dhe kënaqshmërisë së publikut.

Zbatimi duhet të organizohet në tri faza. Në fazën e parë duhet të trajtohen siguria, dëmtimet fizike dhe kushtet bazë të funksionimit. Faza e dytë duhet të përfshijë konservimin, riorganizimin hapësinor, qasshmërinë, digjitalizimin dhe përmirësimin e interpretimit. Në fazën e tretë mund të zhvillohen programet më të gjera edukative e turistike, itinerari i përbashkët kulturor dhe promovimi i koordinuar i dy institucioneve.

SHTOJCA 1

DOKUMENTIMI DHE ANALIZA E INSTITUCIONEVE MUZEALE TË PEJËS – PJESA GRAFIKE

Pjesa grafike përfshin vendosjen në kontekst urban, situacionet, planimetritë, prerjet, fasadat, dokumentimin fotografik, analizën e zhvillimit të hapësirave, rrjedhën e lëvizjes së vizitorëve dhe identifikimin e pengesave në qasshmëri për Muzeun e Pejës dhe Kompleksin e Mullirit të Haxhi Zekës.

BURIMET KRYESORE

Kartela informuese e Muzeut të Pejës, e plotësuar nga institucioni, 2026.

Dokumentacioni ekzistues i muzeve në QRTK.

Dokumentimi dhe analiza e institucioneve muzeale të qytetit të Pejës – pjesa grafike, 2026.

Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës: Kompleksi i Mullirit të Haxhi Zekës.

Peja Tourism: Muzeu i Pejës – historiku institucional dhe Konaku i Tahir Beut.

Lista e figurave

Fig. 1 Muzetë e Pejës; (Burimi: Autoret)

Fig. 2 Muzeu i Pejës; (Burimi: Autoret)

Fig. 3 Foto nga Muzeu i Pejës (Iart) dhe

*Kompleksi i Mullirit Haxhi Zeka (poshtë;)
(Burimi: Autoret)*

*Fig. 4 Kompleksi i Mullirit të Haxhi Zekës;
(Burimi: Autoret)*

*Fig. 5. Analiza e lëvizjes në Muzeun e Pejës;
(Burimi: Autoret)*

*Fig. 6. Analiza e hapësirave të muzeve të Pejës;
(Burimi: Autoret)*

Fig. 7. Pengesa fizike në Muzetë e qytetit të Pejës; (Burimi: Autoret)

Lista e tabelave

*Tab. 1 Kartela e Muzeut të Pejës;
(Burimi: Muzeu i Pejës)*

PËR EC

EC Ma Ndryshe është organizatë me bazë në komunitet, e themeluar në vitin 2006, që angazhohet për zhvillim të qëndrueshëm me qasje gjithëpërfshirëse.

Aktivizmi i EC-it synon një Kosovë ku qeverisja demokratike është pjesëmarrëse, transparente dhe llogaridhënëse, duke siguruar që institucionet, komunitetet dhe palët e interesit të punojnë së bashku drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.

Ky vizion promovon vendimmarrjen gjithëpërfshirëse, politika më të fuqishme dhe përfshirje më të madhe të publikut, duke siguruar që qëndrueshmëria të jetë pjesë përbërëse e qeverisjes si në nivel lokal, ashtu edhe në atë kombëtar.

Përmes koordinimit më të mirë institucional, hartimit të politikave të bazuara në dëshmi dhe angazhimit qytetar, angazhimi i EC-së synon të kapërcejë hendekun mes komuniteteve dhe institucioneve, duke siguruar që qeverisja e mirë të sjellë ndryshime të prekshme dhe afatgjata.

Deklarata e vizionit

“Fuqizimi i një Kosove elastike dhe gjithëpërfshirëse, ku komunitetet në mënyrë aktive formojnë institucione të qëndrueshme, të digjitalizuara dhe të ndërgjegjshme”.

Deklarata e misionit

“EC Ma Ndryshe përkrah qeverisjen demokratike dhe zhvillimin e qëndrueshëm

në Kosovë duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm socioekonomik, kulturor dhe të gjelbër përmes edukimit digjital, kujdestarisë mjedisore, mobilizimit të komuniteteve, avokimit për vendimmarrje publike me pjesëmarrje dhe kultivimit të partneriteteve strategjike”.

